



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 955/4 Prot.

Tiranë, më 18. 09. 2018

V E N D I M

Nr. 179, Datë 18. 09. 2018

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 98, datë 03.07.2018, e bërë nga H. D., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim DPSHTRR), në të cilën pretendon diskriminim *për shkak të bindjeve politike*¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

H. D. sqaron se, ka punuar në pozicionin e Anëtarit të Komisionit të Marrjes në Prova-Provizor, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, nga viti 2010 deri në vitin 2011. Më datë 19.04.2011, është emëruar në pozicionin e Anëtarit të Komisionit të Marrjes në Prova-Praktike. Sipas tij, gjatë detyrës së ushtruar, ka punuar me përkushtim në pozicione të ndryshme pune duke u vlerësuar pozitivisht nga eprorët. Në muajin Janar 2018, është vënë në dijeni të shkresës “*Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës*” dhe më datë 06 Shkurt 2018, punëdhënësi i ka ndërprerë përfundimisht marrëdhëniet e punës.

Sipas ankuesit, largimi i tij nga puna nuk lidhet me ristrukturimin e institucionit, por me bindjet e politike të tij, pasi në organikën aktuale të institucionit jo vetëm që nuk ka shkurtime të pozicioneve të punës në sektorin ku ka punuar, por përkundrazi ka shtim të këtyre pozicioneve, ku nga 12 specialistë-komisionerë që ishin në momentin e largimit, aktualisht janë bërë 13 specialistë.

I ndodhur në këtë situatë, ankuesi pretendon se është diskriminuar nga DPSHTRR, pasi arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nuk lidhen me ndryshimin e strukturës, por me bindjet politike të tij, të kundërta me drejtuesin e institucionit.

¹ Referuar Kartës së Anëtarësisë së lëshuar nga subjekti politik Lëvizja Socialiste për Integrim, Nr. 03020, dt. 28.04.2008

Në përfundim, ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues nga ana e DPSHTRR, si dhe të rekomandojë rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: “ Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32, pika 2 dhe 33, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën me nr. 955 prot., datë 12.07.2018 është njoftuar DPSHTRR dhe i është kërkuar informacion mbi pretendimet e ngritura nga ankuesi.

Në përgjigje³ të shkresës së sipërcituar, DPSHTRR, ndër të tjera sqaroi se, zgjidhja e kontratës së punës me H. D. ka ardhur si rezultat i riorganizimit të punës me qëllim rritjen e performancës dhe jo për shkak të bindjeve politike të ankuesit. Në këtë mënyrë, DPSHTRR, në respektim të

² Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

³ Njëpërmjet shkresës Nr. 12315/1 prot., datë 18.07.2018, protokolluar pranë KMD-së me Nr. 956/1 prot., datë 19.07.2018

dispozitive të parashikuara në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, ka ezauruar të gjitha afatet dhe procedurat për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Gjithashtu, DPSHTRR, theksoi faktin se mbështetur në nenin 12/c të Statutit të DPSHTRR-së, Drejtori i Përgjithshëm emëron dhe liron nga detyra të gjithë punonjësit e saj dhe të Drejtorive Rajonale, me përjashtim të Drejtorëve në Drejtorinë e Përgjithshme.

2. Duke qënë se nevojitej informacion shtesë nga ana e palëve, në vijim mbështetur në Urdhërin Nr. 157, datë 24.08.2018, inspektorët e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u paraqitën pranë DPSHTRR-së për të administruar prova dhe informacione shtesë lidhur me pretendimet e ngritura nga H. D.

Gjatë inspektimit të zhvilluar më datë 30.08.2018, u mor takim me Drejtorin⁴ për Administratën dhe Shërbimet Mbështetëse, si dhe me Përgjegjësen⁵ e Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Sipas përfaqësuesve të DPSHTRR-së, me miratimin e Strukturës dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e këtij institucioni, u vendos që punonjësit me detyrë “*Specialist të Testimit Praktik*” të kishin përfunduar studimet e larta si Inxhinier Mekanik. Në këto kushte, ankuesi është larguar nga detyra pasi nuk plotëson kriterin arsimor “*Inxhinier Mekanik*”. Nga informacioni dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesve të DPSHTRR, rezultoi se gjatë periudhës Janar 2018 e në vazhdim, nuk ka patur largime nga puna të punonjësve të DPSHTRR-së “*Specialist të Testimit Praktik*”. Aktualisht është transferuar nga DRSHTRR Berat, një punonjës në pozicionin “*Specialist të Testimit Praktik*”, cili plotëson kriterin arsimor “*Inxhinier Mekanik*” dhe kërkesat e pozicionit të punës, pranë DPSHTRR-së, duke zëvendësuar H. D.

Përsa më lart, përfaqësuesit e DPSHTRR-së sqaruan se, për asnjë moment nuk kanë patur dijeni lidhur me bindjet politike të ankuesit. Ankuesi nuk ka ngritur për asnjë moment pretendime mbi largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

Në përfundim, inspektorët e KMD-së administrojnë një kopje të dosjes së punonjësit⁶ të emëruar në pozicionin e “*Specialistit të Testimit Praktik*” pranë DPSHTRR. Pavarësisht faktit që në Urdhërin Nr. 157, datë 24.08.2018, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ishte kërkuar: “*Administrimi i informacionit dhe kopje të dosjeve të punonjësve në pozicionin e Specialistit të Testimit, në Sektorin e Testimit Praktik, të DRSHTRR Tiranë, përpara dhe pas ndryshimeve të strukturave*”, nga ana e DPSHTRR-së, nuk u vu në dispozicion një informacion i tillë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

⁴ Z. R. M.

⁵ Znj. Xh. M.

⁶ B. J.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Nga verifikimi i informacioneve dhe dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se, H. D. është emëruar në pozicionin “Anëtar i Komisionit të Marrjes në Prova Teorike” në DRSHTRR Tiranë, me Urdhërin Nr. 196, në vitin 2010. Me Urdhërin Nr. 211, datë 19.04.2011, ankuesi është transferuar në pozicionin “Anëtar i Komisionit të Marrjes në Prova Praktike”. Sipas informacionit të administruar, gjatë detyrës së ushtruar, ndaj ankuesit nuk janë marrë asnjëherë vërejtje apo masa disiplinore. Me anë të shkresës Nr. 1448 prot., datë 26.01.2018, është vënë në dijeni të shkresës “Njoftim mbi fillimin e bisedimeve për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”. Gjatë takimit të zhvilluar me punëdhënësin më datë 01.02.2018, ankuesi është bërë me dije se shkak i ndërprerjes së marrëdhënieve të punës është ristrukturimi i DPSHTRR-së. Përfundimisht, me anë të Urdhërit Nr. 150, datë 06.02.2018, është vendosur largimi nga detyra i H. D. më datë 12.05.2018, për shkak të riorganizimit të institucionit.

Referuar informacionit dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezulton se struktura e DPSHTRR-së ka pësuar dy herë ndryshime. Ndryshimi i parë, është bërë me Urdhërin Nr. 124, datë 20.10.2017 dhe ndryshimi i dytë është realizuar me Urdhërin Nr. 395, datë 23.04.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Damian Gjijnuri. Konstatohet se, ndryshimi i parë është realizuar rreth 3 (tre) muaj përpara, largimit të ankuesit nga pozicioni i punës. Ndërsa ndryshimi i fundit është miratuar pak kohë pas largimit të tij, ndërkohë që ai nuk kishte ndërprerë përfundimisht marrëdhëniet financiare me DPSHTRR-në dhe vijonte marrëdhëniet e punës për efekt të afateve të njoftimit, deri më datë 12.05.2018. Mbështetur në urdhërin Nr. 124, datë 20.10.2017, konstatohet se Dega e Drejtuesve të Mjeteve, Sektori i Testimeve Praktike të DRSHTRR Tiranë, ka në strukturën e saj organizative 12 (dymbëdhjetë) specialist të testimeve praktike. Gjatë periudhës së riorganizimit të DRSHTRR Tiranë, nga provat e vëna në dispozicion nga DPSHTRR, është bërë largimi nga detyra vetëm i H. D. Pas largimit të tij e në vijim, në këtë pozicion me Urdhër Nr. 750, datë 18.06.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, është transferuar nga DRSHTRR Berat, B. J., i cili ishte diplomuar si “Inxhinier Mekanik për Makineri”.

Gjatë procedurave hetimore, nga ana e palëve nuk u vu në dispozicion kopje e strukturës organizative të DRSHTRR Tiranë, përpara asaj të miratuar me Urdhërin Nr. 124, datë 20.10.2017.

Mbështetur në informacionin e dhënë nga ana e përfaqësuesve të DPSHTRR-së, në kuadër të riorganizimit të punës së këtij institucioni, ishte menduar që punonjësit që mbanin detyrën “specialist të testimit praktik”, të kishin përfunduar studimet e larta si “Inxhinier Mekanik”. Me vendim Nr. 09, datë 23.05.2018, Këshilli Drejtues i DPSHTRR-së, kishte vendosur që “specialistët e testimit” të kishin përfunduar studimet e larta si “Inxhinier Mekanik”. Pra, evidentohet se, në kohën kur është bërë largimi i H. D. nga pozicioni i punës, nuk ka qënë e parashikuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funksonimit të DPSHTRR-së, apo ndonjë dokument tjetër, se specialistët e testimit, të kishin përfunduar studimet e larta si “Inxhinier Mekanik”. Nga kontrolli i bërë në dosjen e H. D., është konstatuar se kishte përfunduar studimet pranë Fakultetit të

Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike të Universitetit Tiranë dhe ishte diplomuar si “*Inxhinier Mekanik për Impiante*”.

Pavarësisht faktit që nga ana e KMD-së, për efekt të karahasimit të ankuesit me punonjësit e tjerë, ishte kërkuar kopje e dosjeve të specialistëve të testimit, në mënyrë që të evidentohet arsimi dhe kualifikimet e tyre, nga ana e DPSHTRR-së, nuk u vu në dispozicion asnjë informacion i tillë. Në këto kushte, krijohet dyshimi se në pozicionin e specialistëve të testimit, pranë DPSHTRR-së, mund të ketë patur punonjës të cilët nuk kanë përfunduar studimet si “*Inxhinier mekanik*”.

Në interpretim të dispozitave⁷ të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “*Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë*”, i ndryshuar, punëdhënësi mund të zgjidh kontratën e punës në çdo kohë, por për këtë duhet të ekzistojnë shkaqe të arsyeshme dhe argumenta që justifikojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Nisur nga interpretimet e bëra nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lart, në Vendimin Nr. 19, datë 15.11.2007, rezulton se, barra e provës për të justifikuar zgjidhjen e kontratës së punës i ngarkohet palës punëdhënëse vetëm në rastet e zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës (nenet 153-155 të Kodit të Punës).

Mbështetur në provat dhe informacioni i administruar, gjatë periudhës që ankuesi ka ushtruar detyrën e specialistit të testimit praktik pranë DPSHTRR, nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj tij.

Refruar ndryshimeve të pësuara në strukturën organizative të DPSHTRR-së, me Urdhërin Nr. 395, datë 23.04.2018, konstatohet se Dega e Drejtuesve të Mjeteve, Sektori i Testimeve Praktike të DRSHTRR Tiranë, ka në strukturën e saj organizative 13 (trembëdhjetë) specialist testimi. Përsa konstatohet, në këtë strukturë, është bërë një ndryshim në emërtimin e pozicionit të punës nga “*Specialist të testimeve praktike*” në “*Specialist testimi*”, ndërsa emërtimi i sektorit dhe i drejtorisë ka mbetur i njëjtë. Pavarësisht faktit që gjatë këtij ndryshimi të pësuar, numri i punonjësve *specialist të testimi*, është shtuar me një pozicion më tepër, ky pozicion nuk i është ofruar ankuesit duke qënë se për efekt të afateve të njoftimit, ende nuk i kishte ndërprerë marrëdhëniet financiare me punëdhënësin. Marrëdhëniet financiare të tij me punëdhënësin, sipas Urdhërit Nr. 150, datë 06.02.2018, ndërpriteshin më datë 12.05.2018.

⁷ Neni 143, pika 1, ku parashikohet se: “*Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji, gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet pune, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune*”.

Neni 153, ku përcaktohet se: “*1) Punëdhënësi e punëmarrësi, në çdo kohë, mund të zgjidhin menjëherë kontratën për shkaqe të justifikuar.*

2) Vlerësohen si shkaqe të justifikuar të gjitha rrethanat e rënda që nuk lejojnë, sipas parimit të mirëbesimit, t’i kërkohej atij që ka zgjidhur kontratën, vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

3) Gjykata vendos nëse ekzistojnë shkaqe të justifikuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Konsiderohen shkaqe të justifikuar rastet kur punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me punëmarrësi shkel detyrimet kontraktuale me faj të lehtë, në mënyrë të përsëritur, me gjithë paralajmërimin me shkrim të punëdhënësit.”faj të rëndë, si edhe rastet kur

Pavarësisht faktit që nga ana e këtij institucioni, në referim parashikimeve të Ligjit Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, mund të jenë rrespektuar procedurat dhe afatet e njoftimit për largimin nga puna, punëdhënësi në këtë rast nuk ka bërë me dije ankuesin për ekzistencën e shkaqeve të arsyeshme që justifikojnë zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Megjithëse nga ana DPSHTRR-së është pretenduar se ankuesi është larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të institucionit, si dhe për shkak të ndryshimit të kërkesave të pozicionit të punës lidhur me arsimin, Komisioneri vlerëson se këto argumentime nuk qëndrojnë, pasi nuk është i mbështetur në asnjë nga provat dhe informacionet e vëna në dispozicion nga palët.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankuesit nga puna konstaton se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e tij nga puna është e pajustificuar dhe e pa argumentuar ligjërisht.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin⁸ 2 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues i pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Ankuesi pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese dhe të pabarabartë, nga ana e DPSHTRR-së për shkak të bindjeve të tij politike, shkak i cili është i parashikuar në nenin 1 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Gjatë trajtimit të ankesës së H. D., u administruan prova se ankuesi është anëtarë i subjektivit politik, Lëvizja Socialiste për Integrim që prej vitit 2008.

C. Lidhja e trajtimit të pabarabartë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

⁸ Neni 2: “Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim.”

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e DPSHTRR-së, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁹, për të cilin ankuesi pretendon diskriminim dhe trajtimin të pafavorshëm të tij.

Pas ndryshimeve politike në Shqipëri, në drejtimin e DPSHTRR-së në vitin 2013 u emërua z. Ylli Spahiu, si propozim¹⁰ i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, post të cilin e mbajti deri në muajin Shtator të vitit 2017. Më datë 29.09.2017, pas largimit të z. Spahiu nga detyra, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, u emërua z. Arben Isaraj. Sipas informacionit të administruar në faqen web¹¹ të DPSHTRR-së, në rubrikën ku citohet jetëshkrimi i z. Arben Isaraj, ndër të tjera thuhet se: *“Në zgjedhjet parlamentare mazhoritare të vitit 2005-së, Arben Isaraj kandidoi për deputet në Kuvendin e Shqipërisë, me mbështetjen e Partisë Socialiste, duke shënuar një fitore direkte ndaj rivalit të tij, në zonën zgjedhore nr. 95, Qarku Vlorë. Ai kryesoi në vitin 2009-të listën zgjedhore parlamentare në Qarkun e Vlorës duke fituar mandatin e dytë si përfaqësues i popullit. Gjatë këtyre dy mandateve si deputet i Kuvendit të Shqipërisë (2005-2013) si dhe sekretar e nënkryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Arben Isaraj ishte pjesë përbërëse e komisioneve të përhershme kuvendore të ligjeve dhe sigurisë kombëtare si dhe kryetar e bashkëkryetar i disa komisioneve të posaçme hetimore kuvendore. Nga tetori i 2013-tës deri në shtator 2017-të, Arben Isaraj ka mbajtur detyrën e zëvendësministrit të Drejtësisë.”*

Për faktet që janë të njohura publikisht, bazuar në nenin 80/3 të Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se : *“Për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim ”*, nuk lind nevoja për verifikim.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DPSHTRR:

- Nuk kishte të parashikuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e të saj, apo ndonjë dokument tjetër, se *specialistët e testimit*, të kishin përfunduar studimet e larta si *“Inxhinier Mekanik”*. Pavarësisht këtij fakti, ky arsyetim nuk i ishte bërë me dije ankuesit. Gjithashtu, edhe nëse do të ishte miratuar ndryshimi, se *specialistët e testimit*, duhet të kishin përfunduar studimet e larta si *“Inxhinier Mekanik”*, ankuesi nuk duhet të ishte larguar nga puna me këtë arsyetim.

⁹ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

¹⁰ <http://www.gazetatema.net/2017/09/20/drejtoret-e-lsi-qe-rrezikojne-te-largohen-nga-detyra-ja-emrat/>

¹¹ <http://www.dpshttr.gov.al/treth-dpshttr/struktura-drejtuese/drejtori-i-pergjithshem->

- Fakti që nga ana e DPSHTRR-së nuk u vunë në dispozicion të KMD-së, kopje të dosjeve të specialistëve të testimit, krijon dyshimin se mes tyre mund të ekzistojnë punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin arsimor “*Inxhinier Mekanik*”, të kërkuar nga punëdhënësi.
- Pavarësisht faktit që gjatë këtij ndryshimi të pësuar në strukturën e datës 23.04.2018, numri i punonjësve specialist të testimi, është shtuar me një pozicion më tepër, ky pozicion nuk i është ofruar ankuesit.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se largimi i tij nga puna, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, si dhe Kodi i Punës në ndryshimet e bëra, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast DPSHTRR. Pra, në këtë rast DPSHTRR, duhet të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “*Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 49 të Kushtetutës sipas të cilit “*Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme që e ka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional*”. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për punë.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me

“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹²

Duke iu referuar çështjes Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar, i cili ishte ankuar se shkarkimi i tij nga detyra ishte i motivuar për shkak të bindjeve të tij politike, GJEDNJ-ja¹³ është shprehur se: “...në mungesë të masave mbrojtëse, një sistem ligjor që lejon shkarkimin e punonjësit për shkak të anëtarësisë të punonjësit në një parti politike bart në vetvehte rrezikun potencial për abuzim të mundshëm.”. GJEDNJ theksoi gjithashtu se e drejta e ankuesit për të kundërshtuar largimin e tij nga puna është e vlefshme, pavarësisht bindjeve të tij politike, duke cituar se kjo vjen nga mbrojtja dhe garancia që ofron Neni 11 i Konventës¹⁴.

Po ashtu, në “Kartën Sociale Europiane” të rishikuar¹⁵, dhe shtojcën e saj, në nenin 24, pika 3, germa d) parashikohet se: “...Nuk do të përbëjnë arsye të vlefshme për përfundimin e punësimit:... d) raca, ngjyra, gjinia, gjendja familjare, përgjegjësitë familjare, shtatzania, besimi fetar, **opinionit politik**, prejardhja kombëtare ose origjina sociale”.

Kodi i Punës, i ndryshuar, në nenin 9, të tij ka parashikuar se: “Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohet çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi”. Ndërsa pika 5, germa c) e tij parashikon se: “Në kuptim të këtij neni, ndalimi i diskriminimit dhe zbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion zbatohet në lidhje me:...c) kushtet e punës dhe punësimit, përfshirë zgjidhjen e kontratës së punës dhe pagën”.

Ky parashikim është në të njëjtën frymë me parashikimet ligjore të LMD-së¹⁶. Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është një ligj që rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet në bazë të cilave ndaj një personi mund të ketë diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Gjithashtu në nenin 12 të ligjit 10221/2010 parashikohet se ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën për punësim, për shkaqet e parashikuara në nenin 1.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe

¹² https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discrim_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49.

¹³ Shkurtesë për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

¹⁴ “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij. 2. Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë të të tjerëve. Ky nen nuk ndalon kufizime të ligjshme të ushtrimit të këtyre të drejtave nga pjesëtarë të forcave të armatosura, të policisë ose të administratës shtetërore”.

¹⁵ “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr.8960, datë 24.10.2002.

¹⁶ Referuar neni 3, pika 8 ,e LMD-së.

mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se H. D., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12, nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit H. D., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për shkak të bindjeve politike.
2. Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e H. D. në pozicionin specialist testimi, në Sektorin e Testimeve Praktike, të Degës së Drejtuesve të Mjeteve, në DRSHTRR Tiranë.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)